



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga “MIGJENI” (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

P.SH. Nr. 761/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare, Kimete Gashi Referuese dhe Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “BEDI COM” NTSH Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje te objekteve te shkollave ne QKMF-AMF dhe njërive tjera vartëse te AK” me numër te prokurimit 634-22-8230-111, iniciuar nga Komuna e Klinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 03.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “BEDI COM” NTSH, Prishtinë, e datës 14.12.2022 (Protokoll; 761) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje te objekteve te shkollave ne QKMF-AMF dhe njërive tjera vartëse te AK” me numër te prokurimit 634-22-8230-111, Kurse Anulohet Njooftimi mbi Vendimin e AK të datës 02.12.2022 për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi) në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të LPP.
3. Lejohet kthimi i depozitës së paguar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse Ankuesi ka të drejtë të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.12.2022, Komuna e Klinës në cilësinë e AK, ka publikuar Njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me dru për ngrohje te objekteve te shkollave ne QKMF - AMF dhe njërive tjera vartëse te AK” me numër te prokurimit 634-22-8230-111, ndaj të cilit OE “BEDI COM” NTSH, Prishtinë, me 07.12.2022 ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me vendimin e AK të datës 09.12.2022.

Me 14.12.2022, OE “BEDI COM” NTSH Prishtinë, ka parashtruar ankesë (Nr. Protokolli: 761/22), kundër Njoftimit të cituar si më sipër, për anulim të aktivitetit të e prokurimit, me titull dhe numër siç është përshkruar në paragrafët paraprak.

Me rastin e shqyrtimit paraprak: Është konstatuar se ankesa është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorjë ankesë në OSHP. Ankuesi po ashtu ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen njëherësh dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Meqë OSHP konsideron se ankuesi ka statusin e palës me interes material, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.26, të nenit 4, të LPP dhe meqë Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara, do të thotë se e njëjta bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të Ligjit të cituar.

Bazuar në të lartcekurat, OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues që në pajtim me nenin 113 dhe 114 të LPP, ta bëjë shqyrtimin fillestar të lëndës dhe pretendimeve ankimore. I njëjti me 20.12.2022, ka dorëzuar Raportin e Ekspertizës me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e atakuar të AK, ndërkaq aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim;

Raporti i ekspertit i cituar si më sipër është pranuar nga të dyja palët, me ç ‘rast Ankuesi është pajtuar me raportin, përkatësisht mendimin e ekspertit, përderisa AK është deklaruar se nuk pajtohet.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër dhe ka konvokuar seancën e shqyrtimit kryesor me 09.02.2023, sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit 24 të Rregullores për punën e OSHP, me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes. Pohimet e palëve, provat e administruara dhe shpjegimet e ekspertit janë evidentuar në procesverbalin e kësaj seance, të cilat në këtë rast për nevojat e këtij vendimi prezantohen (shkurtimisht) sikurse vijon:

Ankuesi ka pohuar se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, te LPP duke ekzekutuar aspekte te caktuara të aktivitetit te prokurimit të cilat reduktojnë konkurrencën mes te OE dhe diskriminojnë ankuesin, përderisa sipas LPP, AK nuk do te ekzekutoje asnjë aspekt te aktivitetit te prokurimit i cili redukton apo eliminon konkurrencën mes te OE ose diskriminon ne dem ose ne te mire te një ose me shume OE. Në fakt, pas kërkesës për rishqyrtim AK ka bërë rishqyrtimin e vendimit te datës 31.10.2022 dhe ka vendos për të anuluar tenderin pasi kompania e rekomanduar nuk e kishte plotësuar kriterin e pajisjeve. Prandaj AK nuk duhet të aplikoj standarde të dyfishta lidhur me trajtimin e OE, kurse kriteret duhen vlerësohen siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit [DT] prandaj veprimet e AK në rastin konkret bije ndesh me dispozitën e cituar si më sipër të LPP lidhu me nenin 59 te LPP dhe 39 te RRUOPP. Ankuesi ka pohuar se me rastin e eliminimit, AK ka theksuar se "Ne ofertën tone nuk keni paraqitur qarkullimin financiar" dhe pohon se ka ofertuar në harmoni me kërkesat e DT: *"kontrata për natyrën e njëjtë te punës, pajisjet sipas kërkesës se dosjes se tenderit"*. Në këtë rast, AK ka pasur të drejtë të ndërmerr veprime (për informacione shitesë) në kuptim të nenit 72 dhe 69 të LPP prandaj (sipas ankuesit) ky tender është anuluar në kundërshtim të plotë me nenin 62 të LPP nga AK, ngase ne i plotësojmë dhe i tejkalojmë kërkesat e AK lidhur me këtë aktivitet.

AK, nuk është prezantuar në seancë, mirëpo me 21.10.2022, OSHP ka pranuar përgjigje lidhur me raportin e ekspertit ne cilën thuhet se: Kundërshtojmë ekspertizën e datës 20.12.2022, Eksperti thekson se AK e ka eliminuar Ankuesin për qarkullim financiar, kjo nuk është e vërtet ngase OE "NTSH BEDI COM" është eliminuar sepse nuk ka pasur të prezantuar pajisje konform kërkesave të dosjes së tenderit. Po ashtu derisa në fazën e vlerësimit fillestar Ankuesi nuk ka pasur të prezantuar pajisjet dhe makinerinë sipas DT në bazë të nenit 72 të LPP kërkesat që mund të kërkohen janë ato që prezantohen por nuk përmbushin kriterin. Andaj kërkujmë nga Panelit Shqyrtues qe të hedhet si e pabaze ankesa e ankuesit, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim të aktiviteti të prokurimit.

- Mendimi i ekspertit shqyrtues -

Pretendimet ankimore të Ankuesi, Eksperti Shqyrtues i ka konsideruar të bazuara për faktin parimor se anulimi i tenderit nga ana e AK është bërë ne kundërshtim me dispozitat e LPP, konkretisht me nenin 1 dhe 6, 59, 72 dhe se Njoftimi mbi Vendimin e AK për anulim te Aktivitetit të Prokurimit "Furnizim me dru për ngrohje te objekteve te shkollave ne QKMF - AMF dhe njërive tjera vartëse te AK" me numër te prokurimit: 634-22-8230-111 iniciuar nga AK Kuvendi Komunal i Klinës, nuk është në harmoni me kërkesat e LPP lidhur me nxjerrjen e aktit administrativ. Kurse *"me arsyetimin se nuk keni ofruar pajisje sipas DT ku janë kërkuar minimum 2 kamion mbi 20 T,* sipas Ekspertit Shqyrtues një arsyetim i tillë nuk gjene mbështetje në depozitat e nenit 62, të LPP dhe nenit 44.5 të RRUOPP, andaj AK së pari është dashur të kërkoj sqarime nga OE, e pastaj të dali me vendim përfundimtar. Mbi bazën e të lartcekurave konsideroj që kjo lëndë duhet të kthehet në Rivlerësim.

Pas analizimit të gjithmbarshëm të shkresave të kësaj lënde konstatohet se:

- AK ka aplikuar për këtë aktivitet të prokurimit procedurë të hapur, në harmoni me nenin 32.1 të LPP, duke e përkufizuar llojin e kontratës furnizim, vlera e parashikuar e tenderit 119,519.40 €;
- Lidhur me këtë aktivitetin të prokurimit, janë ndërmarrë veprimet e cituara si më sipër, sikurse janë prezantuar si në hyrje të arsyetimit (Faktet dhe rrethanat procedurale);

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe veprimet e ndërmarrë nga palët (OE dhe AK), Paneli shqyrtues duke i mbështetur gjetjet e ekspertit shqyrtues, konsideron se AK ka bërë shkelje të nenit 59 dhe 72 të LPP, si dhe nenit 39 të RRUOPP, kurse me rastin e rivlerësimit kërkohet që AK të veproj në harmoni të plotë me nenin 59 të LPP i cili parasheh mes tjerash se ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, AK duhet ta bëjë duke u bazuar në kritere dhe kërkesat eksplicite të DT.

Mirëpo, Paneli konsideron po ashtu se, në rastin konkret as AK por as eksperti shqyrtues nuk kanë ofruar prova dhe arsyetim bindës lidhur me faktin se çka konkretisht ka ofruar ankuesi lidhur me kërkesën e AK në kuptim të pikës 9.1&9.2 të DT. Kështu, në aktin e eliminimit (Letra standarde për tenderuesin e eliminuar) AK cek, cituar: *“nuk keni ofruar pajisje sipas dosjes së tenderit”*. Natyrisht pa ndonjë prejjudikim të këtij fakti, Paneli konsideron se në rastet e tilla secili i AK (në cilin do nivel) ka për detyrim të ofroj palës arsytet (fakte dhe prova konkrete) mbi bazën e të cilave pse një kërkesë apo oferta në rastin konkret është refuzuar. Sepse një formulim i tillë, nuk i plotëson kushtet e aktit administrativ, sikurse kërkohet shprehimisht me dispozitën e nenit 44 lidhur me nenin 48 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative. Në këtë rast, AK nuk e ka specifikuar qartë që OE ankues nuk ka pajisje sipas kërkesës së DT, duke mos dhënë sqarim të mjaftueshëm as në procesin e rishqyrtimit sipas nenit 108/A, të LPP, kjo i ka dhënë bazë të mjaftueshme Ankuesit për ta atakuar vendimin e cituar të AK.

- Përfundim -

Duke u bazuar në kompetencat e OSHP të rregulluara sipas nenit 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër. Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur.

Paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komunës së Klinës
- 1x1 OE- “BEDI COM” NTSH Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.